



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.121/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me zyrtaren ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje, dega në Viti, për shkak të vendosjes së banerit në shtylla mbi rrugë publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, dhe subjekt politik Lëvizjes Vetëvendosje, dega në Viti, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,900.00 (njëmijë e nëntëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 07.06.2017, nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkëngjitur si dëshmi fotografinë e printuar nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 07.06.2017, në sheshin kryesor në Viti, monitoruesi i tyre ka hasur në baner të kandidatit për kryeminister Albin Kurti, për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Lëvizja Vetëvendosje, të ngjitur në shtylla mbi rrugë publike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e subjekti politik Lëvizjes Vetëvendosje, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1, e Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së, sepse vendosja banerit të kandidatit për kryeminister mbi shtylla në rrugë publike përbën shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Koalicioni PDK-AAK-NISMA, me datën 08.06.2017, ka paraqitur kërkesë për tërheqje të ankesës, në të cilën kanë deklaruar se tërhiqemi nga të gjitha ankesat që nuk kanë vendim përfundimtar, të parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Në përgjigjen në ankesë Lëvizja Vetëvendosje, të datës 08.06.2017, nuk ka pranuar shkeljen pretenduar në ankesë duke arsyetuar se vendosja e banerit është bërë nga disa simpatizantë të cilët nuk kanë qenë në dijeni se një veprim i tillë përbën shkelje, por me të kuptuar këtë aktivitet pas 15 minutash e kanë larguar atë, i bie se me datën 06 qershor 2017, baneri është larguar dhe se nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit se i njëjti ka qenë aty me datë 07 qershor

2017, andaj kërkojmë nga PZAP që ankesën e parashtruar ta hedhë poshtë si të palejuar. Lidhur me veprimet e ndërmarra përgjegjës në ankesë si provë i kanë bashkëngjitur katër foto nga vendi ku është larguar baneri.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se baneri me kandidatin për kryeministër nga Lëvizja Vetëvendosje, është i vendosur në shtylla mbi rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja e njëjtë nga subjekti politik LVV, është përsëritur disa herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti baneri me kandidatin për kryeministër nga Lëvizja Vetëvendosje, është vendosur në shtylla mbi rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që e kanë tërhequr banerin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, e datës 08.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.121/2017 të datës 07.06.2017, e parashtruar ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njëjës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në neni 54 par.1 të Ligjit për Procedurën Administratave është parashikuar që “*Tërheqja e njëjës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në*

*procedim*". Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i subjektit politik LVV, ka cenuara interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 121/2017 më datën 09.06.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
Rafet Haxhaj

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.***